

VLERËSIM I ROLIT TË ZYRËS SË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË NË RRITJEN E TRANSPARENCËS DHE BESIMIT TË PUBLIKUT NË SISTEMIN E DREJTËSISË

Prof. Dr. Artan Hoxha
Dr. Valbona Ndrepepaj
Dr. Dorina Saja

Ky projekt është realizuar me financimin e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit.

VLERËSIM I ROLIT TË ZYRËS SË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË NË RRITJEN E TRANSPARENCËS DHE BESIMIT TË PUBLIKUT NË SISTEMIN E DREJTËSISË

HYRJE

Në Shqipëri, në vite, ka pasur një perceptim të publikut se, sistemi gjyqësor është i prekur nga fenomeni i korrupsionit. Ky perceptim negativ, i ardhur nga mungesa e praktikave transparente, tejzgjatja e proceseve gjyqësore, apo mungesa e besimit të gjyqësori, nxiti fillimin e reformës më të madhe të Drejtësisë në vend, e cila kulmoi, me krijimin e organeve të reja të qeverisjes së Drejtësisë. Ndër to, u krijua edhe Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (ILD), etj, që është autoriteti përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimit të shkeljeve disiplinore dhe fillimit të procedurës disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm. Më konkretisht, ky institucion, sipas ligjit organik, ka si qëllim rritjen e transparences dhe eficencës në sistemin gjyqësor. Si rrjedhojë e kësaj, të ndikojë edhe në rritjen e besimit dhe aksesit të publikut në drejtësi. Por, edhe pse kanë kaluar më shumë se dy vjet nga konstituimi i kësaj zyre, ende diskutohet mbi nivelin e ulët të transparencës në sistemin gjyqësor dhe besimin e pakët të publikut në reformën në Drejtësi. Pasi, perceptohet se në sistem ka përsëri gjyqtarë apo prokurorë të korruptuar. Në të njëjtën kohë, prej disa aktorëve të tjerë, deklarohet se është rikthyer besimi i publikut në drejtësi, pasi sistemi është pastruar nga këta gjyqtarë apo prokurorë të korruptuar.

Në të vërtetë, mungon kryerja e monitorimeve, studimeve, kërkimeve shkencore apo e vlerësimeve të vazhdueshme për organet e reja të drejtësisë. Kjo do të thotë se, pa studime apo monitorime të tilla, nuk mund të thonim me siguri nëse ILD, si një organ i ri kushtetues dhe i rëndësishëm për mirëqeverisjen e sistemit të drejtësisë, e ka luajtur realisht rolin e tij, - rritjen e transparences dhe besimit të publikut në Drejtësi.

Njëkohësisht, mungesa e të dhënave objektive, të besueshme dhe të paanshme, ka evidentuar nevojën për të vlerësuar, kryesisht, punën e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Ky proces vlerësimi, ka si qëllim t'i ofrojë një publiku të caktuar apo atij në përgjithësi, informacion real mbi

Prof. Dr. Artan Hoxha Dr. Valbona Ndrepepaj Dr. Dorina Saja

punën e kësaj zyre, por edhe të identifikojë shkaqet se *përse* ILD, dy vite pas krijimit, ka një rol të moderuar në rritjen e transparences dhe besimit të publikut në sistemin e drejtësisë.

RISHIKIMI I LITERATURËS

Në ditët e sotme, sistemi gjyqësor duhet të jetë i përgjegjshëm dhe llogaridhënës. Si instrument për këtë, kemi edhe krijimin e sistemeve të inspektimit, të cilat kryesisht janë të pavarura në punën e tyre. Përshëmbull, mund të përmendim, Rrjetin Evropian të Autoriteteve të Inspektimit të Drejtësisë, i cili në nivel europian, propozon dhe zhvillon standarde të përbashkëta për gjyqësorin dhe vlerësimin administrativ të drejtësisë. Po ashtu, kemi figurën e Inspektorit të Drejtësisë në disa vende të këtij rrjeti, si Italia, Franca, Rumania, Bullgaria, Spanja, Mbretëria e Bashkuar. Njohja e organizimit të tyre, ndikimit në fushën e drejtësisë, na shërben në njohjen më të mirë të ILD-së në Shqipëri dhe identifikimit real të rolit të tij.

Rasti i Inspektoratit të Përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë së Italisë[2]

Detyra kryesore e këtij Inspektorati është inspektimi i funksionimit të gjyqësorit. Kjo përfshin kontrollin e organizimit, si: strukturen, mënyren e komunikimit, personelin dhe menaxhimin e tij; si edhe kontrollin e kryerjes së shërbimeve, si: afatin e përgjigjes ndaj kërkesave, mënyrën e përgjigjës ndaj këtyre kërkesave dhe ndjekjen e tyre.

Duhet të përmendim se, funksioni i inspektimit nuk synon vetëm të kërkojë ligjshmëri në kryerjen e rregullt të shërbimeve, por ka edhe një funksion nxitës të praktikave të mira, me opinione, sqarime dhe sugjerime.

Nga pikëpamja funksionale, Inspektori nuk ka kompetenca për marrjen e masave si pasojë e rezultateve të inspektimeve, hetimeve, fakteve. Kjo i përket ministrit, i atribuohet Këshillit të Lartë të Gjyqësorit ose Drejtorive të Përgjithshme të Dikasterit përkatës.

Në këtë kuptim, Inspektorati ka për detyrë të komunikojë rezultatet e kontrolleve dhe të hetimeve paraprake të kryera dhe të vetmet masa që mund të marrë Inspektorati janë ato urgjente, në trajten e rekomandimeve, që synojnë shmangien e paragjykimeve që rrjedhin nga parregullsitë e rënda apo abuzimet e konstatuara gjatë inspektimeve në shërbimet e zyrave gjyqësore.

Më konkretisht, kryen tre llojet të dallueshme të inspektimeve, si:

Të zakonshme, që zhvillohen, sipas ligjit, çdo katër vjet, i cili, si rregull, kryhet prej magjistratëve të Inspektoratit (të ndihmuar nga zyrtarë-inspektorë). Magjistratëve inspektues gjatë verifikimit,

[2] Për këtë seksion është përdorur baza ligjore, si vijon: Royal Decree 8 December 1907, n. 775; Royal Decree 30 January 1941, n. 12 (Judicial system, art. 216-quater); Laë 12 August 1962, n. 1311; dPR 30 June 1972, n. 748 (art. 12); Laë 8 August 1980, n. 426; Laë 6 October 1988, n. 432 (shkarkuar në https://www.normattiva.it/ gjatë muajit prill 2023).

përveç detyrave të kontrollit të rregullsisë së shërbimeve, u ngarkohet edhe detyrimi për të raportuar për masën dhe kohën e punës së kryer nga magjistratët dhe për "aftësinë, zellin dhe rezultatet e tyre në punë".

Të jashtëzakonshme, në rastet kur konstatohet parregullsi.

Të pjesshme, kryesisht për sektorë ose shërbime të veçanta të një zyre gjyqësore dhe synon konstatimin e produktivitetit ose mosfunksionimeve sektoriale.

Inspektimi kryhet nga një ekip i përbërë nga 5 deri në 8 persona, nga të cilët një ose dy janë magjistratë dhe të tjerët janë personel adminstrativ. Të pakten 4 muaj para se të fillojë inspektimi i një gjykate (sipas parashikimeve/kalendarit vjetor të inspektimeve) mblidhen të dhëna për një periudhë pesë vjeçare. Më pas vijohet me inspektimin në gjykatë. Inspektimi në gjykatë zgjat 3 deri në 4 javë, por mund të zgjasë dhe më shumë në varësi të madhësisë së gjykatës. Në perfundim, hartohet raporti i inspektimit dhe verifikimi i masave të marra.

Inspektorati garanton formulimin e propozimeve dhe mendimeve për çështje legjislative që kanë të bëjnë me organizimin e zyrave gjyqësore ose me veprimtaritë e kompetencës së Inspektoratit; shqyrtimin dhe zgjidhjen e çështjeve në lidhje me shërbimet gjyqësore; studimin e çështjeve që kanë të bëjnë me standardizimin e shërbimeve në zyrat e inspektuara; kryerjen e veprimtarive monitoruese të funksioneve të zyrave, që synojnë vlerësimin e anomalive dhe çështjeve kritike, të cilat për shkak të seriozitetit dhe shpeshtësisë së tyre, kanë ndikimin më të madh në funksionimin dhe efikasitetin. të zyrave gjyqësore dhe kryerjen e monitorimeve që synojnë identifikimin e praktikave më të mira të dallueshme duke synuar shpërndarjen e tyre.

Rasti i Inspektoratit të Përgjithshëm i Drejtësisë në Francë

Inspektorati i Përgjithshëm i Drejtësisë në France është një inspektorat i ri, i lindur nga shkrirja e Inspektoratit të Shërbimeve Gjyqësore, Inspektoratit të Sherbimit të Burgjeve dhe Inspektoratit Gjyqësor të Mbrojtjes s të Rinjve, me dekret të 5 dhjetor 2016.

Inspektorati përbëhet nga inspektorët e përgjithshëm, inspektorët dhe përfaqësuesit zyrtarë të rekrutuar nga radhët e magjistratëve, drejtorë dhe drejtorë funksionalë të departamenteve të gjendjes civile, të burgjeve dhe të mbrojtjes gjyqësore të të rinjve dhe rehabilitimit të tyre. Ai integron aftësi dhe ekspertiza të reja dhe të ndryshme (si p.sh administrata civile për të forcuar efektiviteti i qeverisjes). Ky institucion, që raporton drejtpërdrejt të Ministri i Drejtësisë, është i ngarkuar në veçanti me mbikëqyrjen e veprimtarisë së gjykatave dhe të gjitha njësive qendrore dhe të decentralizuara të Ministrisë së Drejtësisë.

VLERËSIM I ROLIT TË ZYRËS SË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË NË RRITJEN E TRANSPARENCËS DHE BESIMIT TË PUBLIKUT NË SISTEMIN E DREJTËSISË

Rasti i Inspektorit të Përgjithshëm të Drejtësisë në Rumani (Inspectia Judiciara)[3]

Inspektori është një organ me personalitet juridik në kuadër të Këshillit të Lartë të Magjistraturës, përgjegjshmëria dhe transparenca e të cilit parashikohen shprehimisht si qëllim i pikës së parë të Mekanizmit të Bashkëpunimit dhe Verifikimit të zhvilluar nga Komisioni Evropian. Inspektori luan një rol kyç në procedimet disiplinore në gjyqësor, i lidhur drejtpërdrejt me objektivin e forcimit të llogaridhënies dhe rrjedhimisht, efikasitetin e gjyqësorit. Për këtë qëllim, atij i janë caktuar një gamë e gjerë detyrash juridiksionale, me ndikim të madh në karrierën e gjyqtarëve dhe prokurorëve, si për shembull kryerja e hetimit disiplinor, një fazë paraprake të detyrueshme për masën disiplinore ndaj gjyqtarit ose prokurorit; kryen kontrolle për të vlerësuar plotësimin e kushteve për kryerjen e detyrës me keqbesim ose neglizhencë të rëndë në rast gabimi gjyqësor; kryen kontrolle në rastin e aplikimeve për mbrojtjen e pavarësisë, paanshmërisë dhe reputacionit profesional të gjyqtarëve dhe prokurorëve; verifikon plotësimin e kushtit të reputacionit të mirë të nevojshëm për ushtrimin e detyrës së gjyqtarit ose prokurorit; verifikon integritetin e aplikantëve të regjistruar në konkursin për ngritjen në detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës së Lartë të Kasacionit dhe Drejtësisë; kryen kontrolle në gjykata dhe prokurori për respektimin e dispozitave ligjore dhe nënligjore, si dhe kryerjen e detyrave drejtuese nga gjyqtarët dhe prokurorët që mbajnë një pozicion drejtues. Inspektori luan një rol kyç në procedimin disiplinor, pasi kryen hetimin paraprak dhe vendos nëse është i nevojshëm fillimi i një hetimi disiplinor.

Më konkretisht, Vendimi i Komisionit 2006/928 për krijimin e një mekanizmi për bashkëpunimin dhe monitorimin e progresit në Rumani kundër standardeve specifike në fushën e reformës gjyqësore dhe luftës kundër korrupsionit. Inspectia Judiciara është një strukturë me personalitet juridik brenda CSM me kompetenca të hetimit disiplinor në lidhje me magjistratët. Drejtohet nga një kryeinspektor, i cili ndihmohet nga një zëvendëskryeinspektor i caktuar prej tij. Kryeinspektori zgjidhet dhe kryen veprimtari inspektuese në bazë të një kuadri institucional në të cilin kryeinspektori është i autorizuar të miratojë akte administrative të natyrës normative dhe individuale.

Inspektori vepron sipas parimit të pavarësisë operacionale në lidhje me Këshillin e Lartë të Magjistraturës, gjykatat, prokuroritë pranë tyre dhe në marrëdhënie me autoritetet e tjera publike, duke ushtruar kompetencat e tij të analizës, verifikimit dhe kontrollit në fushat specifike të veprimtarisë, në zbatim të ligjit. Çdo person i interesuar mund të njoftojë Inspektimin Gjyqësor në lidhje me shkeljet disiplinore të kryera nga gjyqtarët dhe prokurorët.

Kryesisht, Inspektori ka vlerësuar marrdhëniet ndërmjet gjyqësorit dhe medias, respektimi i privatësisë së individëve që janë pjesë e proceseve gjyqësore apo hetimore; kohëzgjatjen e një

[3] Për këtë seksion është përdorur baza ligjore, si vijon: Ligji 303/2022 për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve; Ligji 304/2022 për organizimin gjyqësor; Ligji 305/2022 për Këshillin e Lartë të Magjistraturës; Rregullore për normat e kryerjes së punëve inspektuese nga Inspektimi Gjyqësor; Kodi i etikës së gjyqtarëve dhe prokurorëve Rregullore për organizimin dhe funksionimin e Inspektimit Gjyqësor - 31.08.2022 (shkarkuar gjatë muajit prill 2023).

procesi gjyqësor për çështje civile apo penale – duke iu referuar zgjatjes së arsyeshme të procedurave; kohëzgjatjen e çështjeve specifike penale që kanë të bejne me veprat penale të korrupsionit, evazionit fiskal, pastrimit të parave etj., dhe kohën e lejuar për përgatitjen e vendimeve gjyqësore.

Rasti i Inspektorit të Përgjithshëm të Drejtësisë Bullgari

Ky organ është krijuar në shkurt të vitit 2007, i cili është organ i pavarur dhe funksion kryesor ka të inspektojë aktivitetet e gjyqësorit pa cenuar pavarësinë e tyre. Më konkretisht, ka këto kompetenca: kontrollon organizimin e funksionimit administrativ të gjykatave, prokurorive dhe autoriteteve hetuese, kontrollon masat e marra për ngritjen dhe mbarëvajtjen e çështjeve gjyqësore, prokuroriale dhe hetimore, si dhe zgjidhjen e tyre brenda afateve të përcaktuara, etj.

Që nga 1 janari 2017, ky organ ka edhe kompetencën për kontrollin e integritetit të gjyqtarëve, prokurorëve dhe magjistratëve hetues.

Rasti i Shërbimit të Inspektimit Gjyqësor në Spanjë[4]

Në Spanjë, Këshillit të Përgjithshëm të Gjyqësorit i është dhënë me Kushtetutë autoriteti për të inspektuar dhe monitoruar të gjitha gjykatat. Kjo kompetencë ushtrohet pa cenuar kompetencat inspektuese që u jepen organeve drejtuese të Gjykatave të ndryshme të Lartë të Drejtësisë dhe Gjykatës së Lartë Kombëtare.

Më konkretisht, Departamenti i Inspektimit, kontrollon dhe monitoron funksionimin e shërbimeve të Administratës Gjyqësore duke kryer veprime dhe vizita të urdhëruara nga Këshilli, pa cenuar juridiksionin e organeve drejtuese të Gjykatës dhe në koordinim me to.

Shefi i Departamentit emërohet nga seanca plenare e Këshillit të Përgjithshëm të Gjyqësorit për të njëjtin mandat si Këshilli që e ka emëruar. Drejtimi i Departamentit përbëhet nga një zëvendës magjistrat dhe një avokat i caktuar, të cilët së bashku me shefin e departamentit formojnë Njësinë Qendrore të Inspektimit.

Departamenti i Inspektimit është i ndarë në pesë njësi inspektimi, secila e përbërë nga një ose më shumë inspektorë të deleguar dhe një ose më shumë avokatë. Njësitë janë të organizuara sipas fushës së juridiksionit dhe janë: njësia administrative civile, penale, sociale, kontestimore dhe njësia e përzier që mbulon gjykatat e çështjeve familjare, zotësinë juridike të personave fizik, të miturve dhe mbikëqyrjen e burgjeve.

Ky departament ka në përberjë edhe Divizionin e Statistikave, i cili është përgjegjës për përpunimin, porositjen dhe përdorimin e buletineve statistikore të organeve gjyqësore.

Më konkretisht, Departamenti i Inspektimit ka si detyrë grumbullimin dhe sigurimin e informacionit për gjendjen aktuale të gjykatave. Për këtë qëllim ka një sërë aplikacionesh softuerësh që mbledhin informacionin në dispozicion në lidhje me organet gjyqësore dhe detajet

[4] Nenet 560 dhe 615 të Ligjit Organik për Gjyqësorin.

profesionale të anëtarëve të gjyqësorit. Departamenti i Inspektimit përdor të dhënat e mbledhura për të përpiluar informacione për situatën aktuale të çdo organi juridik ose për një grup organesh, si dhe mbi praktikat e menaxhimit dhe performancën e drejtuesve të tyre.

Në anën tjetër, nëpërmjet monitorimit synon të konstatojë shkallën e respektimit të standardeve të paracaktuara në funksionimin e organeve juridike, si dhe gjendjen aktuale të organeve dhe zbulimin e anomalive të mundshme. Rezultatet e procesit të monitorimit të përfunduar përdoren për të analizuar aspektet më të rëndësishme të organizimit dhe funksionimit të organit gjyqësor si dhe shkaqet që shpjegojnë situatën aktuale të secilit prej tyre, me propozime për çdo përmirësim që gjykohet i nevojshëm. Po ashtu, për të bërë propozime për drejtësinë për zbatimin e masave dhe futjen e udhëzimeve dhe rregullimeve në lidhje me menaxhimin dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit publik të ofruar nga Administrata Gjyqësore.

Sa i përket veprimtarisë së Departamentit të Inspektimit, njësitë e inspektimit kryejnë vizita të zakonshme dhe të jashtëzakonshme në organet e drejtësisë. Vizitat e zakonshme synojnë të konstatojnë informacion të përgjithshëm dhe të detajuar mbi situatën e secilit organ të inspektuar. Vizitat e jashtëzakonshme synojnë marrjen e informacionit për situata specifike. Pas vizitave inspektuese, shkruhet një raport i detajuar inspektimi që propozon masat që konsiderohen të nevojshme, të destinuara si për organin e inspektuar, ashtu edhe për menaxhmentin e departamentit dhe për organe apo subjekte të tjera të çdo lloji.
Si metodikë, përdoren edhe inspektimet on-line. Çdo gjashtë muaj, situata e organeve gjyqësore i nënshtrohet një ekzaminimi të plotë, bazuar në të dhënat e departamentit të statistikave, në përmbajtjen e aplikacioneve të tjera softuerike të Departamentit të Inspektimit dhe në informacionin e marrë nga organet gjyqësore, sipas rastit. Raporti që rezulton nga ky inspektim liston organet që nuk funksionojnë dhe bën propozimet e nevojshme të brendshme dhe të jashtme për përmirësim. Apo raportet. Departamenti i Inspektimit prodhon raporte të të gjitha llojeve të kërkuara nga Komisioni i Përhershëm, Avokati për Veprim Disiplinor dhe Shërbimet dhe Departamentet e ndryshme të Këshillit të Përgjithshëm të Gjyqësorit (masat mbështetëse, proceset e përzgjedhjes së transferimeve, aktivitetet e përputhshme, pushimet, etj.) Raporti janë hartohet edhe për organet dhe subjektet e jashtme sipas kërkesës.

Po ashtu, përdoren edhe të dhënat statisitkore, raportimet e gjykatave, raportet e mëparshme të inspektimeve të bëra në gjykatë, informacioni i marrë nga burime të jashtme, ankesa dhe aktivitete raportuese, analizimi i databazës së institucioneve të tjera ligjzbatuese.

Fazat e Inspektimit janë, si vijon:

- Konstatimi i një parregullsie: njoftimi për një problem të mundëshëm;
- Identifikimi i problemit, arsyet dhe origjina e tij;
- Përpilimi i një raporti me rekomandime;
- Ndjekja e zbatimit të rekomandimeve të përfshira në raport dhe ecuria e problemeve të konstatuara.

Rasti i Inspektorati i Shërbimit të Prokurorisë së Kurorës në Mbretërinë e Bashkuar

VLERËSIM I ROLIT TË ZYRËS SË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË NË RRITJEN E TRANSPARENCËS DHE BESIMIT TË PUBLIKUT NË SISTEMIN E DREJTËSISË

Qëllimi i inspektimeve të Inspektoratit të Shërbimit të Prokurorisë së Kurorës është të mbështesin përmirësimin e vazhdueshëm; të bazojnë gjetjet në prova që janë hulumtuar, verifikuar dhe vlerësuar tërësisht sipas standardeve dhe kritereve të qëndrueshme; të tregojnë integritet, objektivitet dhe profesionalizëm përmes inspektimeve.

Fazat e inspektimit janë:
Faza I: Planifikimi
Faza II: Formimi i grupit të
inspektimit
Faza III: Para-inspektimi
Faza IV: Vizitat në
vendndodhje
Faza V: Vlerësimi dhe hartimi i raportit

Katër inspektoratet e drejtësisë penale janë, Inspektorati i Shërbimit të Prokurorisë së Kurorës së Saj Lartmadhërisë (HMCPSI), Inspektorati i Shërbimit të Sigurisë së Madhërisë së Saj (HMIC), Inspektorati i Burgjeve i Madhërisë së Saj (Burgjet e HMI) dhe Inspektorati i Provës i Madhërisë së Saj (HMI Probation).

HMCPSI ka një detyrë ligjore për të inspektuar funksionimin e Shërbimit të Prokurorisë së Kurorës (CPS) dhe Zyrës së Mashtrimeve të Rënda (SFO).

Qëllimi i inspektimit është të nxisë përmirësime dhe të ndërtojë besimin e publikut në procesin e prokurorisë. Këtë e realizojnë, edhe duke informuar publikun periodikisht për mënyrën se si ata performojnë.

Kryeinspektori i Madhërisë së Tij i Shërbimit të Prokurorisë së Kurorës, kreu i HMCPSI, emërohet nga Prokurori i Përgjithshëm. Ky është një emërim publik për një afat të caktuar. Kryeinspektori vepron në mënyrë të pavarur nga Prokurori i Përgjithshëm dhe nga qeveria.
Detyra ligjore është për të inspektuar funksionimin e CPS dhe SFO dhe t'i raportojmë Prokurorit të Përgjithshëm, i cili mbikëqyr të dyja këto organizata. Raportet e nxjerra nga HMCPSI luajnë një rol të rëndësishëm në mbikëqyrjen efektive.

Marrëdhënia operative midis Prokurorit të Përgjithshëm dhe Kryeinspektorit është përcaktuar në një protokoll të rënë dakord midis Oficerëve të Ligjit (Prokurori i Përgjithshëm dhe Avokati i Përgjithshëm) dhe Kryeinspektorit.

METODOLOGJIA

Prof. Dr. Artan Hoxha Dr. Valbona Ndrepepaj Dr. Dorina Saja

VLERËSIM I ROLIT TË ZYRËS SË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË NË RRITJEN E TRANSPARENCËS DHE BESIMIT TË PUBLIKUT NË SISTEMIN E DREJTËSISË

Në këtë seksion do të diskutohet metodologjia e përdorur për realizimin e qëllimit të këtij studimi, duke u ndalur më konkretisht në detaje të tilla, si: metoda e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave (data collection and data analysis); vlefshmëria dhe besueshmëria e studimit; kufizimet e kërkimit dhe çështjet etike të këtij kërkimit shkencor.

Data collection and data analysis

Për të realizuar pjesën e dytë dhe të tretë të këtij studimi, - *Vlerësimi i rolit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në rritjen e transparencës dhe besimit të publikut në sistemin e drejtësisë,* është përdorur një metodë e përzier tre fazëshe. *Së pari*, është evidentuar dhe analizuar kuadri i plotë ligjor mbi organizimin dhe funksionimin e ILD-së. *Së dyti,* është monitoruar periodikisht online faqja e web-it të ILD-së, si dhe është shqyrtuar vendimmarrja e ILD-së, mbi ankesat e paraqitura. *Së treti,* është vlerësuar aktiviteti i ILD-së, - konkretisht shqyrtimi dhe vendimmarja e ILD-së mbi ankesat e paraqitura, më qëllimin përfundimtar evidentimin e ndikimi të ILD-së në rritjen e transparencës dhe besimit të publikut në sistemin e drejtësisë.

Më konkretisht, *fillimisht*, kemi evidentuar kuadrin e plotë ligjor të organizimit dhe funksionimit të ILD-së; *së dyti*, kemi monitoruar faqen online të ILD-së, krysisht nënseksionin Njoftim Publik për Shpallje Vendimi (https://ild.al/sq/njoftim-publik-per-shpallje-vendimi/), për vitet 2022/ 2023. *Së treti*, kemi përdorur një intervistë të drejtëpërdrejtë, me pyetje të hapura, të hartuara pas monitorimit të faqës online, me dy ekspertë të ligjit që e njohin organizimin dhe funksionimin e brendshëm të ILD-së.

Në vijim, për identifikimin rolit të ILD-së dhe vlerësimin e tij, kemi përdorur, teknikën e tre qasjeve të interpretimit - si metoda kryesore për të gjetur kuptimin e kuptimit - *intentio auctoris*, i cili korrespondon me qëllimin e supozuar të autorit (ligjvënësit apo të hartuesve të reformës në rastin konkret, apo të të intervistuarve); *intentio operis*, i cili përshkruan atë që teksti apo autori në të vërtetë thotë dhe *intentio lectoris*, çfarë përçon teksti apo autori të lexuesi apo dëgjuesi, ose çfarë kuptohet me të (Philips, 2003; Miller & amp; Kaifeng, 2007).

Pra, më konkretisht, si teknikë për analizimin e të dhënave kemi përdorur metodën e interpretimit të përmbajtjes së të dhënave dhe ballafaqimin ndërmjet tyre.

Theksojmë se, pas dakordësisë në parim për të marrë pjesë në studim, pyetjet e intervistës dhe qëllimi i saj, përpara kryerjes, i janë vënë në dispozicion secilit individ të intervistuar, dhe i është kërkuar përseri të shprehen nëse kanë vullnet tí përgjigjen intervistës. E kemi zgjedhur këtë mënyre komunikimi me dy ekspertë, më qëllim që të kuptoheshin disa problematika, të cilat dolën prej procesit të monitorimit.

Intervista, është me dy seksione kryesore. Seksioni I, ka si qëllim të marrë informacion të përgjithshëm demografik të grupit të synuar, përkatësisht si: Mosha, Gjinia, kontakti me ILD-në, etj.

Seksioni II, i cili ka si qëllim të eksplorojë dhe analizojë, ngrihet mbi këto pyetje:

2. Pyetje specifike

1. Si keni qënë në kontakt me ILD-në?
2. Nga eksperienca juaj më ILD, si e vlerësoni rolin e tij në rritjen e transparencës dhe besimit të publikut në sistemin e drejtësisë (ligji çfarë parashikon, e lejon ose jo një rol të tillë, probleme të ligjit)?
3. Nga eksperienca juaj më ILD, si e vlerësoni rolin e tij në rritjen e transparencës dhe besimit të publikut në sistemin e drejtësisë (a e ka ushtruar rolin e dhënë prej ligjit/ arsyet)?

Besueshmëria dhe vlefshmëria

Për të garantuar që të dhënat e mbledhura janë të qëndrueshme dhe të sakta, jemi siguruar që të respektojmë parimin e besueshmërisë dhe vlefshmërisë. Kjo do të thotë se, kemi monitoruar vetëm vendimmmarrjet zyrtare të ILD-së. Së dyti, intervistat janë kryer vetëm tek target grupi i synuar, duke marrë leje paraprake prej tyre. Edhe pse në mënyre informale kemi biseduar me personel të ILD-së apo aktorë të tjerë, ata nuk i kemi intervistuar dhe nuk i kemi bërë pjesë të këtij studimi.

Kufizimet e kërkimit

Në procesin e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave kemi mbajtuar në konsideratë disa faktorë të rëndësishëm që kanë ndikuar në sasinë e të dhënave të mbledhura, por jo në besueshmërinë dhe vlefshmërinë e tyre, si:

- Të dhënat për vitin 2021, në nënseksionin Njoftim Publik për Shpallje Vendimi, nuk rezultojnë të publikuara. Po ashtu, edhe të dhënat e vitit 2022, pas mbledhjes se tyre fillestare, rezultojnë të fshira nga faqja;
- Mungesa e Sistemit elektronik të teknologjisë së informacionit;
- Mosmonitorimi i seancave fizikisht, pasi Zyrat e ILD-së ishin nën ndërtim e sipër, etj.

ROLI I INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË NË SISTEMIN E ORGANEVE TË QEVERISJES SË DREJTËSISË: KUADRI LIGJOR

ILD, i krijuar, në vitin 2016, në kuadër të reformës në drejtësi, është autoriteti shtetëror përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore dhe për fillimin e procedurës disiplinore

ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe për inspektimin institucional të gjykatave dhe zyrave të prokurorisë[5].

Më konkretisht, sipas nenit 147/d dhe në vijim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenit 198 dhe në vijim, të ligjit nr. 115/2016 'Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", si edhe kuadrit tjeter ligjor sektorial, ILD ka tre lloj funksionesh:

- kontrolluese … *është përgjegjës për verifikimin*…;
- hetimore … *hetimin e shkeljeve disiplinore* …;
- inspektuese …. *inspektimin institucional të gjykatave dhe të zyrave të prokurorisë ...*

Pra, ILD, kur shfaqet e nevojshme[6] apo edhe kryesisht[7], mbart përgjegjësinë për të shqyrtuar me kujdes punën e gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm.

Por, për të kuptuar rolin real të ILD-së, në sistemin e organeve të qeverisjes së drejtësisë, *së pari*, duhet analizuar më kujdes procedura e përcaktuar në ligj mbi menyrën e shqyrtimit të ankesave prej ILD-së, si: afatet e parashkrimit, afatet e procedimit, subjektet e ankimit, kriteret për pranushmërinë e kërkesës, shqyrtimi fillestar dhe vlerësimi i ankesës[8]. *Së dyti*, duhet analizuar, marrëdhënieja e ILD-së me institucionet e tjera të rëndësishmë të sistemit qeverisjes së gjyqësorit[9].

Sipas ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ILD vendos të arkivojë ankesën ose të fillojë hetimin për shkeljen e pretenduar, *brenda tre muajve nga marrja e ankesës.* Ndërsa, brenda *gjashtë muajve nga dita e marrjes së vendimit për fillimin e hetimit*, fillon procedimin disiplinor duke i paraqitur Këshillit kompetent raportin e hetimit ose merr vendimin për mbylljen e hetimit. Në raste të caktuara, ILD mund të zgjasë afatin e hetimit, edhe për tre muaj të tjerë në raste komplekse, për arsye të shtimit ose ndryshimit të objektit të hetimit, ose në rast sëmundjeje apo pamundësisë së magjistratit.[10]

Ligji, *prima facie,* parashikon afat të gjata në dispozicion të ILD-së, si për marrjen e vendimit për fillimin e hetimit ose jo, ashtu edhe për fillimin realisht të hetimit disiplinor dhe përcjelljen e tij të këshillat përkatës. Në të vërtetë, dispozita e cituar më lart, kryesisht pika 2 e saj, është e paqartë nëse, ILD e kryen hetimin brenda 6 muajve, apo pret të kalojnë 6 muaj dhe më pas e fillon hetimin, të cilin mund ta shtyjë, në raste të veçanta, dhe për tre muaj të tjerë. Konkretisht, duke bërë një

[5] Neni 147/d, Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

[6] Neni 194, Pika 2, i Ligjit, - Për verifikimin e ankesave ose hetimin e shkeljeve disiplinore ndaj subjekteve, të parashikuara në pikën 1, të këtij neni, Inspektori vihet në lëvizje bazuar në: a) ankimin me shkrim çdo të personi fizik, juridik ose organi publik të interesuar; b) ankimin me shkrim të Ministrit të Drejtësisë; c) ankimin me shkrim të Prokurorit të Përgjithshëm; ç) ankimin me shkrim të secilit anëtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor ose të Këshillit të Lartë të Prokurorisë; d) ankimin me shkrim nga kryetari i gjykatës ku punon gjyqtari që dyshohet se ka kryer shkelje disiplinore; dh) ankimin me shkrim nga drejtuesi i zyrës së prokurorisë ku punon prokurori që dyshohet se ka kryer shkelje disiplinore.

[7] Neni 194 i Ligjit, Pika 3, Inspektori i Lartë i heton shkeljet e dyshuara edhe kryesisht, bazuar në të dhëna publike ose të siguruara në kuadrin e inspektimeve institucionale e tematike, sipas kushteve dhe procedurave të parashikuara në ligjin "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

[8] I referohemi ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

[9] I referohemi ligjit nr. 115/2016 'Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë".

[10] Neni 117, i ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

interpretim literal të saj, shikojmë disa problematika, që e vështirësojnë veprimtarinë e ILD-së në drejtim eficiences, efikasitetit dhe produktivitetit të punës, si afatet e gjata; së dyti, një kolizion dhe paqartësi në normë, - pika 2 me pikën 3 dhe se treti, cili është afati brenda se cilit duhet të mbarojë hetimi. Por, me anë të një interpretimi sistematik të normës, shikojmë se në fakt, kjo nuk është e vertëtë, pasi gjatë kësaj kohë ILD, kryen një sëre veprimesh, si pranon ankesën, e verifikon atë formalisht dhe më pas në përmbajtje, si edhe shprehet me një sërë vendimesh *infra*, duke e treguar seriozitetin e këtij institucioni dhe rëndsinë që ai ka.

Në nenin 118, të ligjit, parashikohet se, ILD duhet t'i konfirmojë ankuesit marrjen e ankesës brenda pesë ditëve nga marrja e saj. Po ashtu, duhet t'i njoftojë ankuesit vendimin për arkivimin e ankesës, për fillimin hetimit, shtimin ose ndryshimin e objektit të tij, si dhe mbylljen e hetimit, brenda pesë ditëve nga marrja e vendimit përkatës. Ankuesi ka të drejtë të ankimojë vendimet për arkivimin dhe mbylljen e hetimit. Këto detyrime të ILD-së, apo në anën tjetër të drejta të subjektit ankues, pavarësisht llojit të tij, - *çdo person fizik ose juridik, apo Ministri i Drejtësisë; një anëtar i vetëm i Këshillit; kryetari i gjykatës ose i prokurorisë*, janë elementë të një procesi të rregullt ligjor, që ndikojnë pozitivisht në transperencen, përgjegjësinë dhe llogaridhënien e punës së ILD-së, pasi e bëjnë atë një institucion të përgjegjshëm dhe llogaridhënës, për pasojë të besueshëm. Po ashtu, këtë të fundit e ndihmon edhe mënyra e paraqitjes së ankesës, - *personalisht, me postë të rregullt, postë elektronike ose faks*, pra një proces i deburokratizuar, si edhe fakti se, tërheqja e ankesës nga ankuesi nuk sjell arkivimin e ankesës, nëse ILD vlerëson se pretendimi ka shkaqe të mjaftueshme për kryerjen e hetimit me iniciativën e tij, si dhe nuk sjell mbylljen e një hetimi të filluar. Kjo do të thotë, se ky institucion është realisht i interesuar për mirembajtjen e trupës së gjyqtarëve, duke ruajtur edhe interesin individual të ankuesit, edhe interesin e personit ndaj të cilit është bërë ankimi, por edhe interesin publik.

Për këtë arsye, - mirembajtja e trupës së gjyqtarëve dhe ruajtja e interesit publik, *së pari*, prej ILD-së ankesa pranohet vetëm nëse përmbush kriteret e mëposhtme:

a) paraqitet në formën e përcaktuar,

b) i referohet fakteve që kanë ndodhur brenda afatit të parashkrimit për hetimin disiplinor;

c) nuk përmban elemente abuzive, nuk është haptazi e pabazuar ose e përsëritur nga i njëjti ankues.

ç) bëhet ndaj sjelljes së magjistratit, i cili ka qenë në detyrë në kohën kur shkelja e pretenduar ka ndodhur;

d) bëhet ndaj sjelljes së magjistratit, të parashikuar si shkelje disiplinore nga ligji në fuqi në kohën kur shkelja e pretenduar ka ndodhur;

dh) bëhet ndaj sjelljes së magjistratit që, nëse provohet se është kryer, përbën shkelje disiplinore të parashikuar nga ligji.[11]

[11] Neni 120, i ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Së dyti, ILD shqyrton fillimisht nëse ankesa është ose jo e pranueshme, i cili, pas shqyrtimit fillestar të ankesës, vendos:

a) të arkivojë ankesën, pasi nuk përmbush një ose më shumë kritere formale të parashikuara;

b) të verifikojë ankesën;

c) të fillojë hetimin. [12]

Me anë të instrumentit të verifikimit, për ankesën që nuk ka informacion të qartë, ILD verifikon nëse ka fakte të mjaftueshme që justifikojnë fillimin e hetimit. Për këtë, mund t'i kërkojë ankuesit të paraqesë dokumente shtesë, të japë shpjegime për mënyrën dhe rrethanat në të cilat ka ndodhur shkelja e pretenduar, mund të marrë çdo informacion tjetër nga këshilli, gjykata ose prokuroria përkatëse.

Vetëm, në rast se nuk ka fakte të mjaftueshme për të justifikuar fillimin e hetimit, ankesa arkivohet. Vendimi i arsyetuar për arkivimin e ankesës i njoftohet ankuesit dhe magjistratit ndaj të cilit është paraqitur ankesa. Ankuesi ka të drejtë të ankimojë këtë vendim në Këshill, brenda një jave nga marrja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.[13]

Inspektori i Lartë i Drejtësisë fillon hetimin nëse ka dyshime të arsyeshme se shkelja mund të jetë kryer, bazuar në faktet dhe provat e mbledhura, që justifikojnë fillimin e hetimit. Vendimi i arsyetuar për fillimin e hetimit i njoftohet ankuesit, magjistratit dhe Këshillit. Vendimi duhet të përmbajë të paktën:

a) emrin e inspektorëve të ngarkuar me hetimin;

b) objektin e hetimit, duke treguar shkeljen e dyshuar;

c) parashtrimin e rrethanave të faktit të pretenduara;

ç) provat e mbledhura;

d) periudhën kohore përkatëse për hetimin;

dh) parashtrimin e të drejtave të magjistratit në lidhje me hetimin disiplinor, si dhe të drejtën e magjistratit dhe të ankuesit për të dorëzuar parashtresë dhe dokumente mbështetëse, brenda tre javëve nga marrja e vendimit.[14]

[12] Neni 121, i ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

[13] Neni 122, i ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

[14] Neni 123, i ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Së treti, ILD mund të fillojë hetimin edhe me iniciativën e tij, bazuar në të dhëna thelbësore mbi fakte që rezultojnë nga burime të besueshme, mbi bazën e të cilave lind dyshimi i arsyeshëm se shkelja mund të jetë kryer. [15]

Së katërti, për një proces të rregullt dhe proporcional hetimi, ligji i ka lënë ILD-së një sërë instrumentash në dispozicion, si: verifikimi i pasurisë dhe figurës së magjistratit[16] (brenda një jave nga vendimi për fillimin e hetimeve); pezullimi i hetimit; pezullimi i magjistratit; thirrja e dëshmitarëve dhe mbledhja të dhënave, dokumentevë dhe provave nga gjykata, prokuroria, institucione publike apo subjekte private, organizata, dëshmitarë dhe/ose magjistrati, dhe ndërmerrja e veprimeve të nevojshme për të hetuar dhe përcaktuar nëse shkelja e pretenduar ka ndodhur[17]; drejton pyetje[18]; njoftimi i palëve dhe dëgjimi i tyre[19]; dokumentimi i hetimit, - dokumenton çdo veprim hetimor me procesverbal dhe harton raportin e hetimit.[20]

Po ashtu, ligji ne nenin 137 të tij parashikon se, ILD administron një sistem të menaxhimit të çështjeve për procedurën hetimore. Sistemi duhet të përmbajë të paktën informacionin e mëposhtëm: a) gjenealitetet dhe adresën e magjistratit nën hetim; b) emrin dhe adresën e ankuesit, nëse është e mundur; c) objektin e hetimit; ç) të dhënat përkatëse mbi zhvillimin e hetimit; d) informacion për arkivimin e ankesës, mbi mbylljen e hetimit ose për fillimin e procedimit disiplinor; dh) informacion për vendimin e formës së prerë për masën disiplinore; e) informacione të tjera, sipas rastit.

Së pesti, edhe për një proces të rregullt dhe ekonomik hetimi, ligji i ka lënë ILD-së një sërë instrumentash në dispozicion, si: bashkimi i procedimeve disiplinore; shtyrja e seancës dëgjimore; ndryshimi ose shtimi i objektit të procedimit disiplinor (në rast se gjatë hetimit ngrihen dyshime të arsyeshme se ka ndodhur një shkelje tjetër, Inspektori i Lartë i Drejtësisë merr vendim për të shtuar ose ndryshuar objektin e hetimit (në rast se gjatë hetimit ngrihen dyshime të arsyeshme se ka ndodhur një shkelje tjetër, Inspektori i Lartë i Drejtësisë merr vendim për të shtuar ose ndryshuar objektin e hetimit)[21].

Bazuar në analizën e kryer më sipër, *mbi procedurën për kryerjen e procedimit disiplinor të magjistratëve prej ILD-së*, rezulton se, është një proces që përmbush karakteristikat e procesit të rregullt ligjor, si: *zyrtar,* - ka rregulla, procedura dhe metoda të paracaktuara në ligj dhe çdo institucion shtetëror, person juridik privat ose individ duhet të veprojë kryesisht dhe të paraqesë një ankesë formale nëse ka prova të mjaftueshme për të besuar që i ka ndodhur një shkelje; *individual,* - kryhet për një magjistrat të caktuar; *i gjithanshëm*, - kryhet një hetim i plotë dhe merret në konsideratë çdo element i nevojshëm; *i hapur dhe transparent*, - palët informohen në proces që nga momenti i fillimit të hetimit, dhe ju garantohet aksesi në dosjen e hetimit në atë masë që është në përputhje me objektin e hetimit; *i moderuar eficient, efikas dhe produktiv*, - marrja e

[15] Neni 124, i ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
[16] Neni 125, i ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
[17] Neni 130, i ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
[18] Neni 130, i ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
[19] Neni 138, i ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
[20] Neni 133, i ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

[21] Neni 126, i ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

një vendimi deri diku brenda një afati të arsyeshëm; *i ligjshëm dhe i besueshëm*, - organi kompetent ka detyrimin të hetojë nëse ka shkaqe të mjaftueshme për të besuar se ka ndodhur një shkelje disiplinore, si edhe ngrihet mbi parimin e prezumimit të pafajësisë dhe mosdënimit pa ligj; *i barabartë*; parimin e dyshimit në favor të magjistratit, subjekt i procedimit disiplinor; *proporcional; i pavaruar*; *konfidencial*, - respektohet jeta private dhe mbrohen të dhënat personale; *i kujdesshëm dhe i balancuar.* Në balancimin e parimit të drejtësisë së hapur, parimit të konfidencialitetit, të drejtës për jetë private dhe mbrojtjen e të dhënave personale, ILD merr parasysh faktin që të garantohet mbrojtja e integritetit dhe figura e magjistratit nga akuzat e pabaza dhe rëndësinë që ka informimi i publikut në lidhje me akuzat e provuara në funksion të administrimit të drejtësisë.[22]

Po ashtu, disa nga shembujt e shkeljes disiplinore që një magjistrat mund të ketë shkaktuar janë ato që kanë të bëjnë me veprime si:

- mospërmbushje të rregullt të detyrës
- shkelje të rregullave të solemnitetit
- shkeljes të sjelljes në marrëdhënie me palët në proçes.
- cënuar parimin e panshmërisë në gjykim, etc.

Të gjithë këto veprime cënojnë prestigjin e figurës së gjyqtarit, si dhe cenojnë besimin e publikut të drejtësia.

Krahas kompetencave për hetim, ILD, ka edhe kompetenca për inspektim, të parashikuara në nenin 147/d, të Kushtetutës, në nenin 194 dhe 204 të Ligjit nr. 116/ 2016. Këto kompetenca kanë të bëjnë më përcaktimin e metodologjisë për inspektimin dhe planifikimin e kryerjes së tyre. Në raportet vjetore[23] të paraqitur para kuvendit prej ILD-së, vërehet se, është fokusuar tek inspektimi tematik dhe ka realizuar 3 (tre) inspektime të tilla, konkretisht: Inspektimi tematik i gjykatave dhe zyrave të prokurorive pranë tyre mbi trajtimin e kërkesave objekt "Lirimin me Kusht"; Inspektimi tematik mbi marrjen e masave administrative dhe procedurale në kuadër të zbatimit të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm "Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm" i ndryshuar dhe "Inspektimi tematik mbi respektimin e kushteve dhe kritereve për caktimin e masave të sigurimit personal" për veprën penale "Të mbajtjes pa leje dhe prodhimit të armëve, armëve shpërthyese dhe municionit". [24]

Synimi i inspektimeve është të vendosë në dispozicion të inspektorëve të ILD-së një mjet të dobishëm procedural për zbatimin e legjislacionit mbi përgjegjësinë disiplinore të magjistratëve,

[22] Neni 100, i ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

[23] Përshembull, shiko faqën nr. 29, të Raportit Vjetor, të vitit 2022.

[24] https://ild.al/sq/2021/05/21/inspektimet-tematike-prioriteti-i-ri-i-inspektorit-te-larte-te-drejtesise/. (shkarkuar maj - qershor, 2023).

duke rritur transparencën që të kontribuojë në rritjen e besimit në organet e sistemit të drejtësisë. Ndaj, ndër objektivat thelbësorë të procesit të inspektimit[25], janë:

1. Identifikimi i praktikave më të mira të punës;
2. Përmirësimi i vazhdueshëm i performancës;
3. Rritja e eficencës;
4. Rritja profesionale, etj.

Pra, ILD gjatë inspektimeve synon të kontrollojë si është gjendja, apo si zbatohen rregullat në lidhje me etikën profesionale të magjistratëve; profesionalizmin gjatë kryerjes së detyrës, veprimtarinë e kryetarëve të gjykatave dhe drejtuesve të zyrave të prokurorive; efektivitetin e zgjidhjes së çështjeve gjyqësore; efektivitetin e nisjes së hetimeve penale, veprimtarinë e administratës gjyqësore dhe zyrës së prokurorisë, etj.[26]

Kryerja e inspektimeve prej ILD-së, mbështetet në zbatimin e parimeve, si: parimi i të drejtës për një proces të rregullt ligjor; ligjshmërisë; barazisë para ligjit; prezumimit të pafajësisë dhe dyshimit në favor të magjistratit; proporcionalitetit; pavarësisë dhe paanësisë së institucioneve disiplinore dhe respektimit të pavarësisë së magjistratit; drejtësisë së hapur; konfidencialitetit, të drejtës së jetës private, mbrojtjes së të dhënave personale dhe informimit të publikut.

Më konkretisht, inspektimet ndahen[27] në inspektime institucionale dhe inspektime tematike.

Inspektimet institucionale, janë ato inspektime që kanë si objekt veprimtarinë funksionale dhe organizative të gjykatave dhe zyrave të prokurorisë, menaxhimin e çështjeve dhe administrimin gjyqësor dhe hetimor. Qëllimi i tyre është evidentimi i funksionimit të administrimit të drejtësisë dhe vlerësimit të performancës së tyre, duke vlerësuar tërësinë e veprimtarisë administrative të këtyre institucioneve, si sekretarinë, respektimin e kodit të etikes; administrimin e fondeve, hedhja e shortit, funksionimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve elektronike.

Inspektimet tematike lidhen me një natyrë çështjesh të përcaktuara qartë në objektin e Inspektimit. Inspektimi mund të ketë për objekt dy qëllime, inspektim me karakter njohës së efektivitetit të veprimtarisë hetimore/gjyqësore të magjistratit, ose inspektim për efekt të evidentimit dhe dokumentimit të shkeljeve disiplinore nga magjistrati.

Metodologjia e përdorur nga grupi i inspektimit[28], është:

1. Fizikisht, në selinë e subjekteve (gjykatave dhe zyrave të prokurorisë):
i. këqyrjen e regjistrave;
ii. identifikimin dhe studimin e fashikujve objekt kontrolli;
iii. marrjen e kopjeve (fizike të akteve të nevojshme);
iv. marrjen në pyetje dhe zhvillimin e intervistave me magjistratët;

[25] Ibid.
[26] Neni 101 – 104, ligji nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
[27] Bazuar në metodologjinë e inspektimit, miratuar me urdhërin nr. 121, datë 30.12.2022.
[28] Bazuar në metodologjinë e inspektimit, miratuar me urdhërin nr. 121, datë 30.12.2022.

v. analizimin e korrespodencës së palëve me gjykatën dhe zyrën e prokurorisë.

2. Elektronikisht, duke shkëmbyer praktikat dhe dokumentacionin nëpërmjet postës elektronike:
i. Paraqitjen e kërkesave në rrugë elektronike, për ato të dhëna që mund të merren në format elektronik (statistika, urdhra, vendime, rregullore, buxhet etj.

3. Online, përmes kryerjes së inspektimeve të sistemeve të teknologjisë së informacionit:
i. vëzhgimin e procedurave elektronike;
ii. kontroll për mbajtjen dhe përdorimin e mjeteve teknike, audiovizive dhe kompjuterike;
iii. përdorim apo funksion të realizuar në sistem elektronik kur një gjë e tillë është e përcaktuar në akt ligjor.

Bazuar në analizën e kryer më sipër, *mbi procedurën për kryerjen e inspektimeve të gjykatave dhe zyrave të prokurorisë prej ILD-së*, rezulton se, është një proces që përmbush karakteristikat e procesit të rregullt ligjor, si: *zyrtar,* - ka rregulla, procedura dhe metoda të paracaktuara në ligj dhe manualin e miratuar, *i gjithanshëm*, - një hetim i plotë dhe merret në konsideratë çdo element i nevojshëm; *i hapur dhe transparent*, - palët informohen në proces që nga momenti i fillimit të inspektimit, *i pavaruar*; *i kujdesshëm dhe i balancuar,* etj.

Në anën tjetër, siç e kemi cekur, duhet analizuar edhe marrëdhënia e ILD-së me institucionet e tjera të rëndësishmë të qeverisjes së gjyqësorit, për të vërtetuar rolin real të këtij institucioni në rritjen e transparencës dhe besimit të publikut në sistemin e drejtësisë.

ILD - Këshilli i Lartë Gjyqësor / i Prokurorisë

Në sistemin e qeverisjes së drejtësisë, Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Inspektori i Lartë të Drejtësisë, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, si dhe Shkolla e Magjistraturës janë një grup institucionesh që bashkohen për të kryer detyra të ndryshme për të arritur një qëllim të përbashkët, - pavarësinë, llogaridhënien, transparencën dhe efiçencën e sistemit të drejtësisë në Republikën e Shqipërisë. Këto institucione, ndryshojnë në rol dhe përgjegjësi.

Përshembull, Këshillat kanë të drejtë të pranojnë ose jo kërkesat e lëshuara nga ILD-ja për procedimet disiplinore ndaj gjyqtarëve[29]. Më konretisht, kur Këshillat çmojnë se çështja nuk mund të zgjidhet në mënyrë të drejtë dhe të rregullt, pa marrë në shqyrtim një ose disa pretendime të tjera për shkeljen disiplinore ndaj të njëjtit magjistrat, kanë të drejtë:

[29] Nenin 147/a pika 1, shkronja "b" të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 63 të ligjit nr.115/2016, "Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë", të ndryshuar, në nenin 138, pika 2 të Ligjit nr.96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe në nenin 31, pika 1 dhe 2 të Rregullores, "Për procedurat disiplinore në Këshillin e Lartë Gjyqësor".

a) të urdhërojnë Inspektorin e Lartë të Drejtësisë të ndryshojë ose të shtojë objektin e procedimit disiplinor, në përputhje ligjin, si dhe të hetojë këto pretendime të tjera të paktën brenda afatit njëmujor;

b) të vendosë mbi pretendimet e ndryshuara ose të shtuara, nëse nuk është i nevojshëm hetim i mëtejshëm, pasi të ketë dëgjuar palët në procedim. [30]

Pavarësisht sa më sipër, ILD ka një rol qendror dhe të rëndësishëm. Ndaj edhe kompetenca e mësipërme e Këshillave është një formulë kryesisht bashkëpunimi dhe më pas monitorimi. Kjo do të thotë se, marrëdhënia e tyre institucionale kryesisht konsiston në vendosjen e standardeve më të mira të procedimit disiplinor[31], për edukimin e magjistratëve për të qenë në lartësinë e detyrës që kryejnë. Po ashtu, mund të ndodhë, që gjatë këtij bashkëpunimi, edhe të adresohen problematika me interes të përbashkët[32]. Përshëmbull, mbledhja plenare që realizohet nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë merret me shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të komisioneve, me përjashtim të atyre vendimeve që rrëzojnë vendimet e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankimeve ose pushimin e hetimeve[33]. Për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankimit ose pushimin e hetimit ndaj një prokurori, krijohet një komision i përkohshëm, i përbërë nga 2 anëtarë joprokurorë dhe 1 anëtar prokuror, ku përbërja e këtij komisioni përcaktohet me short nga Kryetari i Këshillit. Në mbledhjen plenare të Këshillit, si dhe në mbledhjen e Komisionit Disiplinor, nuk marrin pjesë anëtarët e Këshillit, të cilët kanë bërë kërkesën mbi bazën e së cilës ka nisur hetimi për shqyrtimin e propozimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vendosjen e masave disiplinore[34].

Në të vërtetë, roli qendror dhe i rëndësishëm i ILD-së ndërmjet organeve të tjera të sistemit të qeverisjes së gjyqësorit, tregohet edhe nga fakti se shkeljet disiplinore të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor/ Prokurorisë hetohen nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në bazë të procedurave dhe rregullave të parashikuara në ligjin "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë"[35]. Ndërkohë që është Gjykata Kushtetuese ajo që shqyrton ankimet kundër vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankesës ose mbylljen e hetimit ndaj anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor[36].

Po ashtu, Ministri i Drejtësisë mund ti kërkojë ILD-se kryerjen e inspektimeve institucionale e tematike në Prokurorinë e Përgjithshme ose në zyrat e prokurorisë apo edhe mund të paraqesë ankesë tek ai për shkelje disiplinore të pretenduara të prokurorëve[37]. Gjithashtu, Ministri i Drejtësisë[38], mund të paraqesë ankesë tek ILD edhe për shkelje disiplinore të pretenduara të

[30] Neni 144, i ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
[31] Neni 104, ligji "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar.
[32] Neni 106, ligji Nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë".

[33] Neni 159 pika 2 shkronja d, ligji "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar.
[34] Neni 159 pika 3, ligji "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar.
[35] Neni 6 PIKA 1, ligji "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar.
[36] NENI 6 PIKA 2, ligji "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar.
[37] Neni 169, pika 2, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar.
[38] Neni 71 , ligji"Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar.

gjyqtarëve, si dhe mund të kërkojë nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë kryerjen e inspektimeve institucionale e tematike në gjykata.

ILD - Pushteti Gjyqesor

Në marrëdhënien ILD - pushtet gjyqësor, rolin e ILD-së, përveç sa më sipër, e shohim edhe përsa i përket ndarjes së çështjeve gjyqsore, e cila bëhet me short në rrugë elekronike. Më konkretisht, ILD kryen të gjitha inspektimet e ndarjes së çështjeve me short dhe gjithashtu çdo vit kontrollon raportet e sistemit elektronik[39]. Aktet e tij të kontrollit dhe inspektimit përfshihen në diskutimt periodike që bëhen në kuadër të mbledhjes së përgjithshme të gjyqtarëve.

ILD - Prokurori i Përgjithshëm

Në marrëdhënien ILD - Prokurori i Përgjithshëm, rolin e rëndësishëm të ILD-së e shohim edhe në rastin e paraqitjes së shprehjes së interesit për pozicionin e punës Prokuror i Përgjithshëm. Në këtë rast, Komisioni përkatës, që shqyrton dokumentacionin e paraqitur nga kandidatët, kërkon raportim[40] nga institucionet kompetente si, ILD, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, prokuroria, organet e administratës tatimore dhe doganore, Byroja Kombëtare e Hetimit, Shërbimet Shtetërore Informative, Autoriteti per Informimin mbi Dokumentet e ish - Sigurimit te Shtetit, etj.

Po ashtu, në vijim të kësaj marrëdhënie bashkëpunimi, Prokurori i Përgjithshëm i kërkon ILD-së të kryejë inspektime tematike ose hetime për shkeljet individuale. Ndërkohë vetë ILD kryen rregullisht, të paktën çdo vit, një inspektim tematik mbi praktikën dhe shkaqet e zëvendësimit të prokurorëve[41], apo mbi caktimin e çështjeve.

Po ashtu, si Prokurori i Përgjithshëm ashtu edhe Drejtuesi i Prokuroris së posacme për cështjet që janë në juridiksdionin e tyre kanë për detyrim të bashkëpunojnë më ILD-në dhe ta informojnë atë në lidhje me çfarëdolloj shkeljeje disiplinore apo problematikë që mund të hasin në ushtrimin e aktivitetit të tyre të perditshëm[42].

ILD - Këshilli për Emërimet në Drejtësi

[39] Neni 25, pika 4, e ligjit nr. 98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë".
[40] Neni 31, Pika 2, ligji Nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë".
[41] Neni 49, Pika 6, ligji Nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë".
[42] Neni, 110, Pika 1, ligji Nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë".

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi është organ i pavarur që verifikon përmbushjen e kushteve ligjore dhe vlerëson kriteret profesionale e morale të kandidatëve për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese dhe kandidatëve për Inspektor të Lartë të Drejtësisë.

Këshilli për Emërimet në Drejtësi rendit dhe përcakton rradhen e individëve që do të përzgjidhen më pas nga Kuvendi për detyrën e Inspektorit të lartë të Drejtësisë.

ILD - Gjykata Kushtetuese

Një ndër detyrat kryesore të Gjykatës Kushtetuese është edhe shkarkimi nga detyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në rastin e shkeljeve disiplinore të bërë nga ai[43]. Disa nga ato shkelje disiplinore jane:

- neglizhencë të rëndë në ushtrimin e detyrave;
- mosrespektim haptazi të ligjit;
- neglizhencë të rëndë në drejtimin e Zyrës së Inspektorit dhe në mbikëqyrjen e veprimtarisë së inspektorëve;
- kryerja e një veprimtarie te papajtueshme me funksionin zyrtar;
- përhapja e informacionit konfidencial të përftuar gjatë ushtrimit të funksionit zyrtar;
- kryerja e sjelljeve që diskreditojnë rëndë dinjitetin e institucionit;
- është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi.

Besimi i publikut dhe transparenca e gjyqësorit janë garanci të demokracisë, stabilitetit dhe qeverisjes së mirë në shtetin e së drejtës. Ndaj ligji me formulën e zgjedhur mbi organizimin dhe funksionimin e ILD-së, kompetencat e tij ligjore dhe mënyrën e ushtrimit të tyre, vendin centrik në sistemin e organeve të drejtësisë, i ka dhënë ILD-së, një rol të rëndësishëm në rritjen e transparencës dhe besimit të publikut në sistemin e drejtësisë në vend.

Më përjashtim të konfliktit në dukje ndërmjet parimeve të eficiences, efikasitetit dhe produktivitetit dhe atyre të transperences, përgjegjësisë dhe llogaridhënies *supra*, përseri kemi garanci që ky institucion të këtë një rol në rritjen e transparences dhe besimit të publikut në sistemin e drejtësisë.

MONITORIMI DHE VLERËSIMI I PUNËS SË ZYRËS SË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË

Monitorimi

[43] Neni 207, ligji "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar.

E kemi theksuar gjatë këtij studimi se, ILD është një organ i pavarur kushtetues, i cili luan funksionin e autoriteti përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore dhe fillimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Prokurorit të Përgjithshëm, po ashtu, kryen dhe inspektimin institucional të gjykatave dhe të zyrave të prokurorisë. Pra, ligji me formulën e zgjedhur mbi organizimin dhe funksionimin, kompetencat e tij ligjore dhe mënyrën e ushtrimit të tyre, vendin centrik në sistemin e organeve të drejtësisë, i ka një rol të rëndësishëm në rritjen e transparencës dhe besimit të publikut në sistemin e drejtësisë në vend.

Për të parë më siguri, nëse ligji, me krijimin e ILD-së, ka sjellë apo jo pasojën e dëshiruar, si: rritjen e transparences dhe besimit të publikut në Drejtësi, kemi monitoruar online dhe analizuar, prej 12 janarit 2022- korrik 2023[44], ankesat e paraqitura në ILD dhe vendimmarrjen e tij në kuadër të tyre. Për këtë, jemi bazuar të informacioni i publikuar në faqen zyrtare të ILD-së. Më konkretisht, në seksionin e emërtuar "*njoftime*", - nënseksioni "*njoftim publike për shpallje vendimi*", ku gjenden të pasqyruara të gjitha njoftimet me shpallje për ankesa të depozituara nga persona fizikë/juridikë.

Më pas, pas marrjes së informacionit në nënseksionin e mësipërm, kemi ndërtuar, për secilin vit, një tabelë më indikatorët, si vijon:

Tabela nr. 1 - Indikatorët e shqyrtimit të ankesave të administruara të vitit 2022/ 2023

Nr	**Shpallje vendimi rreth ankesave të vitit 202…**							
	Vendimi	**Ankuesi**		**I padituri**	**Vendimarrja e ILD**	**Arsyeja e vendimarrjes**	**KLP/ KLGJ**	**Vendimarrja e KLP/ KLGJ**

Më konkretisht, për vitin 2022, - periudha janar - nëntor, ne kemi parë dhe shqyrtuar 90 ankesa. Pas analizë së bërë këtyre ankesave, rezulton se, 88 ankesa janë paraqitur nga individë, ku një prej të cilëve me statusin avokat, ndërkohë 2 ankesat e tjera janë paraqitur nga persona juridikë private. Pjesa më e madhe e ketyre ankesave, rezulton se, kanë si objekt të tyre problematika, si: ankesa ndaj vendimmarrjeve të padrejta të magjistratëve gjatë shqyrtimit të çështjeve; pretendime për zvarritje të gjykimit nga ana e magjistratëve dhe shkelje procedurale nga ana e magjistratëve. Nga këto ankesa të shqyrtuara, ILD ka vendosur që 85 prej tyre ti arkivojë, ndërsa për 5 ankesa ka vendosur fillimin dhe përfundimin e procedurës së verifikimit të ankesës. Pas hetimit të arsyeve të

[44] Në muajin Qershor, 2023 nuk rezulton të ketë vendimmarrje (https://ild.al/sq/njoftim-publik-per-shpallje-vendimi/).

arkivimit të pjesës më të madhe të ankesave, rezulton se, në këto raste, ankesa nuk përmbush një ose më shumë nga kriteret e pranueshmërisë së ankesave, si:

1) ankesa bëhet ndaj sjelljes së magjistratit, të parashikuar si shkelje disiplinore nga ligji në fuqi në kohën kur shkelja e pretenduar ka ndodhur;
2) ankesa bëhet ndaj sjelljes së magjistratit që, nëse provohet se është kryer, përbën shkelje disiplinore të parashikuar nga ligji.
3) i referohet fakteve që kanë ndodhur brenda afatit të parashkrimit për hetimin disiplinor;
4) nuk përmban elemente abuzive, nuk është haptazi e pabazuar ose e përsëritur nga i njëjti ankues.

Ndëresa, në rastet kur ILD ka vendosur përfundimin e procedurës së verifikimit të ankesës, rezulton se arsyet, janë: pamundësia në objekt apo qëllim, organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur, etj.

Pra, është vënë re se, kryesisht, ILD ka vendosur arkivimin e ankesës, pasi ankuesi nuk ka fakte dhe prova të mjaftueshme për të bazuar ankesën e tij. Pra, mungesa e provave, do të bënte ILD-në më pak objektive në vendimarrjen dhe shqyrtimin e ankesës.

Pavarësisht, sa më sipër, vërehet një numer i lehtë rastesh, - vetëm 4, kur në ILD ka pasur individë që kanë paraqitur raste të përsëritur ankesash.

Edhe në këto raste, ILD ka vendosur të arkivojë ankesën, pasi nuk përmbush një ose më shumë nga kriteret që duhet të përmbushë ankesa, si: nuk ka fakte të mjaftueshme për të justifikuar fillimin e hetimit, ankesa arkivohet, etj.

Për vitin 2023 - janar- korrik, ne kemi parë dhe shyrtuar 61 ankesa. Nga këto 61 ankesa, 10 prej tyre janë paraqitur nga institucione të ndryshme publike dhe private. Pjesa më e madhe e ketyre ankesave kanë, edhe gjatë vitit 2023, si objekt të tyre, problematika, si: ankesa ndaj vendimmarrjeve të padrejta të magjistratëve gjatë shqyrtimit të çështjeve; pretendime për zvarritje të gjykimit nga ana e magjistratëve dhe shkelje procedurale nga ana e magjistratëve. ILD ka vendosur që nga 61 ankesa të paraqitura, 60 ankesa ti arkivojë, ndërsa për 1 ankesë ka vendosur përfundimin dhe mbylljen e hetimit disiplinor. Arsyeja pse, ILD ka vendosur më së shumti arkivimin e çështjeve është pasi ankesa nuk përmbush një ose më shumë kritere të parashikuar si të domosdoshme për pranimin e saj. Kryesisht, mosparaqitje e ankesës në formën e përcaktuar, mungesa e provave dhe pamjaftueshmëria e faktve për fillimin e hetimit dhe kalimi i afateve.

Në ndryshim nga viti 2022, në vitin 2023, nuk rezulton të kemi raste kur, në ILD të ketë pasur individë që kanë paraqitur raste të përsëritur ankesash.

Ndërsa, *sipas Raporti të ILD-së për vitin 2022*[45], gjatë vitit 2022 … *"janë depozituar 789 ankesa të reja, të ndara këto sipas subjekteve ankuese rezulton:*

1. *756 ankesa të depozituara nga persona fizikë;*
2. *33 ankesa të depozituara nga persona juridikë;*

Nga analizimi i fakteve, ligjit dhe arsyetimit të dhënë në vendime, ka rezultuar se shkaqet kryesore për arkivimin e ankesave të depozituara janë:

1. *Shkelja e pretenduar nuk parashikohej si shkelje disiplinore nga ligji në fuqi;*
2. *Në kohën e shqyrtimit të ankesës, magjistrati nuk ushtronte funksionin e tij;*

Rezultatet e hetimit disiplinor janë si vijon:

1. *Për 6 magjistratë (3 gjyqtarë dhe 3 prokurorë) janë paraqitur pranë këshillave respektive kërkesat për procedim;*
2. *Për 1 magjistrat (1 gjyqtar) është pezulluar hetimi deri në marrjen e një vendimi përfundimtar për procesin e rivlerësimit;*
3. *Për 22 magjistratë (20 gjyqtarë dhe 2 prokurorë) është mbyllur hetimi disiplinor për shkak të:*

- *mbarimit të statusit të magjistratit;*
- *vlerësimit të fakteve, rrethanave të hetuara dhe provave të marra, si të pamjaftueshme për të provuar shkeljet e pretenduara;*
- *për 14 magjistratë (13 gjyqtarë dhe 1 prokuror) të hetimit disiplinor, procedurat hetimore janë në proces.*

Për 8 subjektet të hetimit disiplinor, hetimi ndaj të cilëve ka filluar në vitin 2021, hetimet kanë vijuar edhe gjatë vitit 2022, konkretisht:

- *Për 2 magjistratë është pezulluar hetimi;*
- *Për 3 magjistratë dhe 3 subjekte të tjerë, është mbyllur hetimit.*

Këshillat në të gjitha rastet e paraqitura nga ILD kanë pranuar të gjitha gjetjet për shkeljet disiplinore të konstatuara në raportet hetimore, KPA gjithashtu ka lënë në fuqi kërkesat për procedim disiplinor të kërkuara nga ILD dhe masat e vendosura nga Këshillat.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, pasi ka hetuar rastet dhe nga analizimi i fakteve dhe kuadrit ligjor në fuqi, ka konstatuar se përfundimi i hetimeve ka ardhur si pasojë e:

1. *Paraqitjes së kërkesës për procedim disiplinor;*
2. *Faktet dhe rrethanat e zbuluara gjatë hetimit nuk justifikojnë fillimin e procedimit disiplinor;*
3. *Mbarimit të statusit të magjistratit, si një ndër kriteret ligjore për mbylljen e hetimit.*

Gjatë vitit 2022, ILD ka marrë 1224 vendime objekt ankimi pranë Komisioneve të Përkohshme, nga ku rezulton se kundër vendimeve janë depozituar:

1. *83 ankime ndaj 862 vendimeve të arkivimit pas shqyrtimit fillestar;*
2. *15 ankime ndaj 344 vendimeve të arkivimit pas verifikimit;*

[45] https://ild.al/sq/2023/05/05/raporti-i-punes-per-vitin-2022/ (shkarkuar në Korrik, 2023, pasi është publikuar në Maj, 2023).

3. *1 ankim ndaj 18 vendimeve për mbylljen e hetimit disiplinor.*

Gjatë vitit 2022, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka kërkuar fillimin e procedimit disiplinor për 6 magjistratë, për 3 magjistratë kërkesat për procedim janë paraqitur pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe për 3 magjistratë kërkesat për procedim janë paraqitur pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë."

Pas analizimit të informacionit të mësipërm, vihet re e njejta tendence, sipas monitorimit tonë online dhe raportit vjetor të ILD-së, - administrimi i një numri të lartë ankesash; arkivimi i një numri të lartë ankesash dhe vendimmarrje përtej afatit ligjor, pasi, përshëmbull, gjatë vitit 2023, është marrë vendim arkivimi për ankesa të administruara gjatë vitit 2020 dhe 2021.

Ndaj, për të arritur në një përfundim *infra*, kemi marrë në konsideratë edhe disa elementë të tjerë, që na vinë prej kryqëzimit të informacionit të mësipërm, dhe informacionit të marrë në disa burime të tjera.

Së pari, *publikimi dhe komunikimi i informacionit,* vërejmë se, këto ankesa që publikohen, kanë rrjedhshmmëri publikimi, pra çdo ankesë e re që i paraqitet institucionit të ILD, publikohet dhe bëhet transparente për publikun, në formën e një njoftimi me shpallje për ankesën. Gjithashtu, një kërkesë apo ankesë, përveç publikimit fillestar, është në përditësim dhe ndryshim të vazhdushëm. Kjo do të thotë se, publiku njoftohet për administrimin e kërkesës/ankesës; përcjelljen e saj pranë organeve kompetente; përgjigjen e tyre, etj.

Së dyti, *numri i ankesave të paraqitura dhe trajtimi i tyre*, sipas raportimit të ILD-së, vërejme se, në vitin 2023 janë mbartur për shqyrtim 1072 ankesa, të depozituara nga viti 2022. Që do të thotë, do të trajtohen jashtë afatit ligjor.

Tabela nr. 2 - Ecuria e trajtimit të ankesave të mbartura 2020-2023

Viti	**Gjendje backlog**	**Trajtuar**	**Mbetur për t'u trajtuar**
2020	2104	65	2,039
2021	2039	433	1606
2022	1606	534	1072
2023	1072	-	-

Së treti, *vendbanimin apo vendqendrimin e ankuesve*, vërejmë se, ankuesit të cilët i drejtohen ILD banojnë në të gjthë Shqipërinë, por numrin më të lartë të ankuesve e zë Qarku i Tiranës, që ndiqet më pas nga Qarku i Durrësit, etj. Duke pasur në vëmendje numrin e popullsisë në këto qarqe, kjo

tregon një përfshirje të gjërë të qytetarëve që e kanë zgjedhur ILD, si një institucion ku mund të gjëjnë zgjidhje. Po ashtu, tregon edhe një rritje të ndërgjegjes qytetare që për çfarëdolloj shkeljeje, pavarësisht se kush mund të jetë shkelësi i të drejtës së tyre (gjyqtarë apo prokurorë), përveçse kanë të drejtë ti drejtohen institucioneve përkatëse, mundet edhe të marrin shërbimin e duhur.

Së katërti, *objekti i ankesave*, vërejmë se, problematikat apo pretendimet e ngritura më së shumti nga ankuesit janë, vendimmarrje të padrejta të magjistratëve gjatë shqyrtimit të çështjeve; zvarritje të gjykimit nga ana e magjistratëve; shkelje procedurale nga ana e magjistratëve.

Së pesti, *shkaqet e arkivimit të ankesave të depozituara nga ILD*, vërejmë se, janë mungesa e provave, shkeljet e pretenduara nuk parashikoheshin si shkelje disiplinore në ligjin në fuqi, apo në kohën e shqyrtimit të ankesës, magjistrati nuk ushtronte funksionin e tij.

Së gjashti, *numri i kërkesave të përcjella në KLP/ KLGJ dhe rezultati i tyre*, vërejmë se, gjatë vitit 2022, ILD ka kërkuar fillimin e procedimit disiplinor për 6 magjistratë, për 3 magjistratë kërkesat për procedim janë paraqitur pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe për 3 magjistratë kërkesat për procedim janë paraqitur pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Ndërsa, deri në gusht 2023[46], vërejme se, ka paraqitur 3 kërkesa në KLP[47], nga të cilat 2 janë pranuar dhe 1 është pezulluar dhe përafërsisht kërkesa në KLGJ, ku për 8 prej është vendosur pezullim; për 10 prej tyre ka filluar procedimi; prej 8 prej tyre është caktuar masë; 2 prej tyre është vendosur mbyllja e procedimit dhe në dy raste KLGJ ka pranuar kërkesën e ILD-së.

Së shtati, *natyra e çështjeve të cilat i janë drejtuar ILD*, vërejmë se, janë çështje të cilat i përkasin fushës civile, penale ose administrative.

Se teti, *inspektimet me iniciative/ hetime të nisura kryesisht*, vërejmë se, numri i tyrë është i vogël, duke passjellë një rol jo aktiv të ILD-së në këtë drejtim.

Së nënti, prej *aktivitetit të përditshëm të ILD-së*, vërejmë se, shyqrtimi i ankesave është realizuar në mënyrë, publike, përtej afatit ligjor dhe duke pasur në fokus rritjen e transparencës dhe ndërgjegjësimin e publikut, pasi, në vazhdimësi, kryhen takime me qytetarët për dhënie informacioni apo sqarime të nevojshme për ankesat dhe rolin e ILD-së; publikohen rezultatet e veprimtarisë; dalje publike në masmedia (media tradicionale dhe online), etj. Po ashtu, në faqen zyrtare të ILD-së, kemi seksionin *Si pranohen ankesat,* ku shpjegohet rrugëtimi i një ankesë në ILD dhe ju jepet përgjigje disa pyetjeve, të cilat qartësojnë qytetarin apo të interesuarin, mbi përdorimin me efektivitet të këtij instrumenti.[48]


Së dhjeti, *intervistat e kryera*, që për shkak të numrit të ulët, përgjigjet e tyre nuk janë zbardhur, por kanë shërbyer si instrument për të provuar gjetjet tona nga monitorimi. Por theksojnë se, ILD ka trashëguar dhe administruar një numër të madh ankesash; ka mungesë personeli si dhe ligji parashikon afate relativisht të gjata trajtimi të ankesave të paraqitura.

[46] https://klgj.al/akte-administrative-individuale-2/ (parë së fundmi në gusht, 2023).
[47] https://klp.al/category/vendime-akte-administrative/ (parë së fundmi në gusht, 2023).
[48] https://ild.al/sq/pyetje-te-shpeshta/ (parë së fundmi në korrik, 2023).

Vlerësimi

Duke pasur në konsideratë kohën kur ILD, ka filluar të veprojë efektivisht, si edhe informacionin e mësipërm, kemi zgjedhur një kohë e ndërmjetme vlerësimi (*interim evaluation*) dhe si metodë vlerësimi kemi përdorur OECD-DAC (2015) Evaluation Criteria[49], si një metodë e përdorur gjerësisht në vlerësimin e impaktit të politikave ligjore. Kjo metodë mbështet në disa indikatorë, si:

Figurë nr. 1 - Evaluation Criteria (OECD-DAC (2015)



Por, ne kemi marrë në konsideratë, ato indikatorë, që, në opinionin tonë, tregojnë se një politikë ka një impakt pozitiv apo negativ mbi rritjen e transparencës dhe besimit të publikut në qeverisjen në përgjithësi dhe në veçanti në atë të gjyqësorit. Më konkretisht, *rëndësinë*[50], *efektivitetin dhe efikasitetin*[51], *qëndrueshmërinë*[52] dhe *koherencën*.

[49] https://www.oecd.org/dac/evaluation/daccriteriaforevaluatingdevelopmentassistance.htm (parë së fundmi në korrik, 2023).

[50] Shkalla në të cilën objektivat e një ndërhyrjeje janë në përputhje me kërkesat e qytetarëve, nevojat e vendit, etj.

[51] Shkalla në të cilën objektivat e ndërhyrjes janë arritur ose pritet të arrihen.

[52] Vazhdimësia e përfitimeve nga ndërhyrja.

Pas kryqëzimit të informacionit të marrë me këta indikatorë dhe intervistave, rezulton se, *duke marrë si indikator kohën/ koherencën*, ILD ka realizuar një procedim administrativ *deri diku efikas dhe efektiv të hetimit dhe shqyrtimit të shkeljeve disiplinore*[53], të kryera nga ana e magjistratëve, kjo jo sepse nuk ka vullnetin e duhur, por pasi nuk ka pasur/ nuk ka në dispozicion burimet e nevojshme njerzore, vetëm aktualisht, - gusht 2023, kanë 9 pozicione inspektor vakante[54], si edhe nuk ka infrastrukturën e duhur teknike, - nuk rezulton të jetë ndërtuar ende sistemi i menaxhimit të ankesave, detyrim që buron prej ligjit. Pra, më siguri mund të themi se, ILD ka trashëguar dhe administruar një numër të madh ankesash; pjesa më e madhe e tyre janë trajtuar jashtë afatit *supra,* edhe se *perse* ligji parashikon afate relativisht të gjata; pjesa më e madhe e ankesave, për mungesë provash, janë arkivuar, - edhe *perse* nga ana e tij është bërë një punë e mirë në drejtim të edukimit të publikut për kthimin e ILD-së në një instrument efektiv; një pjesë e vogël rastesh është përcjellë në KLP/ KLGJ dhe në të shumtën e rasteve prej tyre është konfirmuar vendimmarrja e ILD-së.

Ndërsa, *duke marrë si indikator transparencen*, ILD ka realizuar një *procedim administrativ deri diku efikas të hetimit dhe shqyrtimit të shkeljeve disiplinore*, të kryera nga ana e magjistratëve, pasi ka krijuar një infrasrukturë që publiku të njoftohet për administrimin e kërkesës/ankesës; përcjelljess e saj pranë organeve kompetente, përgjigjen e tyre, etj. Pasi nuk rezulton të jetë ndërtuar ende sistemi i menaxhimit të ankesave, detyrim që buron prej ligjit.

Pra, jo për mungesëen e vullnetit, por për shkak se është një institucion i ri, disa problemeve të ligjit, mungesës së infrastrukturës, ILD, ka një rol të moderuar në rritjen e transparences dhe besimit të publikut në sistemin e drejtësisë. Ky rol do të rritet në të ardhmen, pasi vërehet, *së pari,* nga viti në vit rritja e numrit të qytetarëve që e zgjedhin si një instrument juridik dhe *së dyti,* zvogëlimi i kohës së trajtimit të një ankesë.

Edhe, Kuvendi i Shqipërisë, në rezolutën e tij drejtuar ILD-së[55], e ka vlerësuar punën e saj, por i ka rekomanduar: …

6. Vijimin me ritme të shpejta të trajtimit të ankesave të dorëzuara nga organet kompetente gjatë periudhës kalimtare, si dhe trajtimin me përparësi të ankesave, të cilat për shkak të parashikimeve të nenit 117 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokuroreve në Republiken e Shqipërisë" mund te parashkruhen, duke shmangur kështu arkivimin e tyre pa bëre të mundur verifikimin dhe hetimin nga institucioni.

7. Ndjekjen me prioritet të ankesave ndaj magjistratëve në proces vetingu në funksion të përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies së tyre.

….

[53] Për shkak të numrit të ulët të intervistave, përgjigjet e tyre nuk janë zbardhur, por kanë shërbyer si instrument për të provuar gjetjet tona nga monitorimi.
[54] https://ild.al/sq/zyra-e-inspektorit-te-larte-te-drejtesise/stafi-yne/ (parë në gusht, 2023).
[55] https://ild.al/wp-content/uploads/2022/09/Rezolute-e-Kuvendit-per-vitin-2021.pdf (parë në gusht, 2023).

9. Rishikimin e objektivave të punës dhe hartimin e nje plani të ri strategjik, të shtrirë në kohë dhe sipas një metodologjie të bashkërenduar për të shërbyer si një bazë për planifikim të përgjithshëm dhe për menaxhimin e performancës.

...

11. Vijimin dhe rritjen e transparencës ndaj publikut nëpërmjet përdorimit të kanalevë të ndryshme të komunikimit publik. ...”

KONKLUZIONE

Në përfundim të procesit të identifikimit dhe vlerësimit të rolit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në rritjen e transparences dhe besimit të publikut në sistemin e drejtësisë, *rezultoi se,* sipas ligjit, ILD është kompetent dhe ka tre lloj funksionesh, si: kontrolluese, hetimore dhe inspektuese, në rastin e procedimit disiplinor të magjistratëve dhe kryerjen e inspektimeve të gjykatave dhe zyrave të prokurorisë. Ligji, ka parashikuar mekanizmin për ushtrimin e këtyre funksioneve në përputhje me procesin e rregullt ligjor, pasi në përgjithësi ka parashikuar modalitete për përmbushjen e karakteristikave të një procesi të tillë, si: *zyrtar, i gjithanshëm*, *i hapur dhe transparent*, *i pavaruar*; *i kujdesshëm dhe i balancuar,* etj. Po ashtu, në raport më organet e tjera të sistemit të qeverisjes së gjyqësorit, ligji i ka dhënë një vend dhe rëndësi.

Kjo do të thotë se, ligji, me formulën e zgjedhur mbi organizimin dhe funksionimin e ILD-së, kompetencat e tij ligjore dhe mënyrën e ushtrimit të tyre, vendin centrik në sistemin e organeve të drejtësisë, i ka dhënë një rol të rëndësishëm në rritjen e transparencës dhe besimit të publikut në sistemin e drejtësisë në vend. Pavarësisht se, në dukje, kemi një konflikt ndërmjet parimeve të eficiences, efikasitetit dhe produktivitetit dhe atyre të transperences, përgjegjësisë dhe llogaridhënies. Por, përseri kemi garanci që ky institucion të këtë një rol në rritjen e transparences dhe besimit të publikut në sistemin e drejtësisë.

Së dyti, pas kryerjes se procesit të monitorimit dhe kryqëzimit të informacionit të marrë, rezulton se, ILD, ka luajtur një rol të moderuar në rritjen e transparences dhe besimit të publikut në sistemin e drejtësisë, por jo për mungesëen e vullnetit, por për shkak se është një institucion i ri, disa problemeve të ligjit, mungesës së infrastrukturës. Ky rol do të rritet në të ardhmen, pasi vërehet, *së pari,* nga viti në vit rritja e numrit të qytetarëve që e zgjedhin si një instrument juridik dhe *së dyti,* zvogëlimi i kohës së trajtimit të një ankesë.

Për të maksimizuar rolin e ILD-së në rritjen e transparences dhe besimit të publikut në sistemin e drejtësisë, do të rekomandonim:

1. Rritja e bashkëpunimit mes institucioneve (shkëmbimit të eksperiencave; unifikimit të metodave dhe praktikave më të mira në përputhje me standardet e demokracisë dhe shtetit të së drejtës).

2. Hartimi i një planin veprimi nga secili insitucion në kuadër të bashkëpunimit ndërmjet organeve të drejtësisë. (bazuar te kërkesa e ILD drejtuar Kuvendit për krijimin e një mekanizmin mbikëqyrës, i nevojshëm për matjen e performancës së institucioneve të drejtësisë).
3. Përmirësim të infrastrukturës IT.
4. Nxitja e edukimit ligjor.

BIBLIOGRAFI

https://www.normattiva.it/;

Ligji i Republikës së Rumanisë nr. 303/2022 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve";

Ligjii i Republikës së Rumanisë nr. 304/2022 "Për organizimin gjyqësor";

Ligji i Republikës së Rumanisë nr. 305/2022 ''Për Këshillin e Lartë të Magjistraturës"; Rregullorja e Republikës së Rumanisëpër "Për normat e kryerjes së punëve inspektuese nga Inspektimi Gjyqësor;

Kodi i Republikës së Rumanisë "Mbi etikën e gjyqtarëve dhe prokurorëve";

Rregullorja e Republikës së Rumanisë "Për organizimin dhe funksionimin e Inspektimit Gjyqësor";

Ligji i Mbretërisë së Spanjës "Për Gjyqësorin"

Armstrong. M, (2007), Performance Management, Key Strategies and Practical Guidelines, third editions by Kogan Page, London.

Philips, 2003; Miller & amp; Kaifeng, 2007

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

https://ild.al/sq/njoftim-publik-per-shpallje-vendimi/

Ligji i Republikës së Shqipërisë nr. 115/2016 'Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar;

Ligji i Republikës së Shqipërisë nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë",

https://ild.al/sq/2021/05/21/inspektimet-tematike-prioriteti-i-ri-i-inspektorit-te-larte-te-drejtesise/;

https://ild.al/sq/2023/05/05/raporti-i-punes-per-vitin-2022/;

Metodologjia e inspektimit, miratuar me urdhërin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, nr. 121, datë 30.12.2022;
Ligji i Republikës së Shqipërisë nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë";

https://ild.al/wp-content/uploads/2022/09/Rezolute-e-Kuvendit-per-vitin-2021.pdf;

https://klgj.al/akte-administrative-individuale-2/;

https://klp.al/category/vendime-akte-administrative/;

https://www.oecd.org/dac/evaluation/daccriteriaforevaluatingdevelopmentassistance.htm;